

VENDIMI ËSHTË I PLOTFUQISHËM
 DHE I Detyrueshëm
 GJYKATA THEMELORE / OSNOVNI SUD
 FERIZAJ I UROSEVAC NË EMËR TË POPULLIT

Më
 Data 30. 04. 2018

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ – DEPARTAMENTI I
 PËRGJITHSHËM – DIVIZIONI PENAL, me Gjyqtarin e vetëm gjykues Adem

Shabani dhe zyrtarin ligjor Blend Rexhepi në lëndën penale kundër të akuzuarve [REDACTED]
 [REDACTED], [REDACTED], [REDACTED], [REDACTED], [REDACTED], [REDACTED] për
 shkak se në bashkëkryerje kryen veprën penale lëndim i lehtë trupor nga neni 188 par. 1
 lidhur me nenin 31 të KPRK-së, sipas aktakuzës të Prokurorisë Themelore në Ferizaj
 PP/II.nr.1559-4/15 të datës 16.10.2017, pas mbajtjes së shqyrtimit fillestar në prani të
 prokurorit të shtetit Ismet Rrahmani, të akuzuarve me dt: 06.03.2018, shpall dhe
 publikisht komunikon këtë:

A K T G J Y K I M

Të akuzuarit:

[REDACTED], nga [REDACTED] K. [REDACTED], i lindur me [REDACTED],
 nga i ati [REDACTED] dhe e ëma [REDACTED] e gjinisë [REDACTED], ka te kryer shkollën e mesme, i
 martuar, babë i katër fëmijëve, i gjendjes se mesme ekonomike, shqiptar, shtetas i
 Republikës së Kosovës, me nr.personal [REDACTED],-

[REDACTED], nga [REDACTED] RR'' [REDACTED]', i lindur me [REDACTED] nga i
 ati [REDACTED] dhe e ëma [REDACTED] e gjinisë [REDACTED], ka te kryer shkollën e mesme, student, i
 martuar, babë i tre fëmijëve, i gjendjes se mesme ekonomike, punon privat, shqiptar,
 shtetas i Republikës së Kosovës, me numër personal, [REDACTED],

[REDACTED], nga Ferizaj RR'' [REDACTED]', i lindur me [REDACTED],
 nga i ati [REDACTED] dhe e ëma [REDACTED] e gjinisë [REDACTED], ka te kryer shkollën e mesme, i pa
 martuar, i gjendjes se mesme ekonomike, punon privat, bashkëpronar '' [REDACTED] '
 shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, me numër personal [REDACTED],-

██████████, nga fsh. ████████ K. ████████, i lindur me ████████ nga i ati ████████ dhe e ëma ████████ e gjinisë ████████ ka te kryer shkollën e mesme, i martuar, babë i tre fëmijëve, i gjendjes se mesme ekonomike, punon privat, bashkëpronar “██████████” shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, me numër personal ████████.-

██████████, nga fsh. ████████ K. ████████, i lindur me ████████ nga i ati ████████, ka te kryer shkollën e mesme, i martuar, babë i pesë fëmijëve, i gjendjes se mesme ekonomike, punon privat, punëtor sigurimi “Skifterat”, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, mr numër personal, ████████.-

██████████, nga ████████ “██████████”, i lindur me ████████ nga i ati ████████ dhe e ëma ████████ e gjinisë ████████, ka te kryer shkollën e mesme, i martuar, babë i tre fëmijëve, i gjendjes se mesme ekonomike, punëtor sigurimi “██████████”, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, me numër personal ████████.-

JANË FAJTOR

Se me dt.06.08.2015 në rr”Liman Reka” në Ferizaj, gjersa të dëmtuarit ████████ dhe ████████ ishin para diskotekës “Coco Club” në Ferizaj, të pandehurit i kanë sulmuar të dëmtuarit duke i goditur me grushta në pjesët e ndryshme të trupit duke i shkaktuar lëndime të lehta trupore të përshkruara si në ekspertizën e ekspertit të mjekësisë ligjore të dt.15.06.2016, e të cilat lëndime rezultojnë me pasoja të përkohshme të shëndetit,-

-Me çka në bashkëkryerje kanë kryer veprën penale lëndim i lehtë trupor nga neni 188 par. 1 lidhur me nenin 31 të KPRK-së,

Gjykata në bazë të neneve 4, 7, 41, 46, dhe 73 të KPRK-së, dhe nenit 365 të KPPK-së të akuzuarin e

GJYKON

I. Të akuzuarit ████████, i shqipton dënimin me gjobë në shumë prej 100 /njëqind/ Euro, të cilin dënim me gjobë është i obliguar ta paguan në afat prej 30 ditësh, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Në rast se personi i dënuar nuk dëshiron ose nuk mundet ta paguan dënimin në të holla, sipas nenit 46 par.3 të KPK-së, i njëjti dënim do t'i shndërrohet në dënim me burgim ashtu që për çdo 20 Euro, do t'i llogaritet një (1) ditë burgim.

Obligohet i akuzuari që në emër të paushallit gjyqësor të paguaj shumën prej 20 €, dhe taksen në shumën prej 30 /tridhjetë/ Euro, konform nenit 39 paragrafi 3 nën paragrafi 3.1 të Ligjit për Kompensimin e Viktimave të Krimit këto në afat prej 30 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

II. Të akuzuarit [REDAKTUAR], i shqipton dënimin me gjobë në shumë prej 100 /njëqind/ Euro, të cilin dënim me gjobë është i obliguar ta paguan në afat prej 30 ditësh, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Në rast se personi i dënuar nuk dëshiron ose nuk mundet ta paguan dënimin në të holla, sipas nenit 46 par.3 të KPK-së, i njëjti dënim do t'i shndërrohet në dënim me burgim ashtu që për çdo 20 Euro, do t'i llogaritet një (1) ditë burgim.

Obligohet i akuzuari që në emër të paushallit gjyqësor të paguaj shumën prej 20 €, dhe taksen në shumën prej 30 /tridhjetë/ Euro, konform nenit 39 paragrafi 3 nën paragrafi 3.1 të Ligjit për Kompensimin e Viktimave të Krimit këto në afat prej 30 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

III. Të akuzuarit [REDAKTUAR], i shqipton dënimin me gjobë në shumë prej 100 /njëqind/ Euro, të cilin dënim me gjobë është i obliguar ta paguan në afat prej 30 ditësh, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Në rast se personi i dënuar nuk dëshiron ose nuk mundet ta paguan dënimin në të holla, sipas nenit 46 par.3 të KPK-së, i njëjti dënim do t'i shndërrohet në dënim me burgim ashtu që për çdo 20 Euro, do t'i llogaritet një (1) ditë burgim.

Obligohet i akuzuari që në emër të shpenzimeve gjyqësore dhe paushallit gjyqësor të paguaj shumën prej 20 €, dhe taksen në shumën prej 30 /tridhjetë/ Euro, konform nenit 39 paragrafi 3 nën paragrafi 3.1 të Ligjit për Kompensimin e Viktimave të Krimit këto në afat prej 30 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

IV. Të akuzuarit [REDAKTUAR], i shqipton dënimin me gjobë në shumë prej 100 /njëqind/ Euro, të cilin dënim me gjobë është i obliguar ta paguan në afat prej 30 ditësh, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Në rast se personi i dënuar nuk dëshiron ose nuk mundet ta paguan dënimin në të holla, sipas nenit 46 par.3 të KPK-së, i njëjti dënim do t'i shndërrohet në dënim me burgim ashtu që për çdo 20 Euro, do t'i llogaritet një (1) ditë burgim.

Obligohet i akuzuari që në emër të shpenzimeve gjyqësore dhe paushallit gjyqësor të paguaj shumën prej 20 €, dhe taksën në shumën prej 30 /tridhjetë/ Euro, konform nenit 39 paragrafi 3 nën paragrafi 3.1 të Ligjit për Kompensimin e Viktimave të Krimit këto në afat prej 30 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

V. Të akuzuarit [REDAKTUAR], i shqipton dënimin me gjobë në shumë prej 100 /njëqind e pesëdhjetë/ Euro, të cilin dënim me gjobë është i obliguar ta paguan në afat prej 30 ditësh, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Në rast se personi i dënuar nuk dëshiron ose nuk mundet ta paguan dënimin në të holla, sipas nenit 46 par.3 të KPK-së, i njëjti dënim do t'i shndërrohet në dënim me burgim ashtu që për çdo 20 Euro, do t'i llogaritet një (1) ditë burgim.

Obligohet i akuzuari që në emër të shpenzimeve gjyqësore dhe paushallit gjyqësor të paguaj shumën prej 20 €, dhe taksën në shumën prej 30 /tridhjetë/ Euro, konform nenit 39 paragrafi 3 nën paragrafi 3.1 të Ligjit për Kompensimin e Viktimave të Krimit këto në afat prej 30 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

VI. Të akuzuarit [REDAKTUAR], i shqipton dënimin me gjobë në shumë prej 100 /njëqind/ Euro, të cilin dënim me gjobë është i obliguar ta paguan në afat prej 30 ditësh, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Në rast se personi i dënuar nuk dëshiron ose nuk mundet ta paguan dënimin në të holla, sipas nenit 46 par.3 të KPK-së, i njëjti dënim do t'i shndërrohet në dënim me burgim ashtu që për çdo 20 Euro, do t'i llogaritet një (1) ditë burgim.

Obligohet i akuzuari që në emër të shpenzimeve gjyqësore dhe paushallit gjyqësor të paguaj shumën prej 20 €, dhe taksën në shumën prej 30 /tridhjetë/ Euro, konform nenit 39 paragrafi 3 nën paragrafi 3.1 të Ligjit për Kompensimin e Viktimave të Krimit këto në afat prej 30 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Të dëmtuarit [REDAKTUAR] nga Prishtina rruga "[REDAKTUAR]" dhe [REDAKTUAR] [REDAKTUAR] vendi i lindjes në [REDAKTUAR] me vendbanim në [REDAKTUAR] për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohen në kontest civil.

A r s y e t i m i

Prokuroria Themelore në Ferizaj, me aktakuzë PP/II.nr.1559-4/15 të datës 16.10.2017, ka akuzuar [REDAKTUAR], [REDAKTUAR], [REDAKTUAR], [REDAKTUAR],

██████████ ██████████ për shkak se në bashkëkryerje kryen veprën penale lëndim i lehtë trupor nga neni 188 par. 1 lidhur me nenin 31 të KPRK-së.

Gjykata caktoi dhe mbajti shqyrtimin fillestar me datë 06.03.2018, në të cilën shqyrtim të akuzuarit janë deklaruar fajtor për veprën penale të cilën e ngarkon akuza, kanë shprehur pendim për veprën e kryer, kanë shprehur keqardhje, i kërkojnë falje të dëmtuarve, është hera e parë që bien ndesh me ligjin, i premtojnë gjykatës se në të ardhmen nuk do të përsërisin vepra të tilla apo të ngjashme penale, lusin gjykatën që t'iu shqiptoj një dënim sa më të butë.

Prokurori me rastin e paraqitjes së mendimit të tij, ka propozuar që të pranohet pranimi i fajësisë për të akuzuarit pasi që një pranim i tillë është bërë vullnetarisht nga ana e të akuzuarve secilit veç e veç dhe të njëjtit ti shpall fajtor dhe ti shqiptohet një dënim i paraparë me ligj.

Pasi që të akuzuarit kanë pranuar fajësinë, Gjykata për të vlerësuar pranimin e fajësisë dhe shqyrtoi me kujdes faktet e parapara nga neni 248 par. 1 të KPPK-së dhe me këtë rast vlerësoi se të akuzuarit e kanë kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimi të fajit, pranimi është bërë vullnetarisht nga ana e të akuzuarve, pranimi i fajit mbështet në faktet dhe prova materiale të rastit konkret dhe atë me provat e paraqitura nga Prokurori i Shtetit siq janë : ekspertiza e ekspertit të mjekësisë ligjore i dt.15.06.2016 si dhe shkresat e tjera të lëndës.

Meqenëse të akuzuarit kanë pranuar fajësinë e cila është në përputhje me kriteret e përshkruara më lartë, gjykata konform nenit 248 paragrafit 4 të KPPK-së, ka vlerësuar se nuk është e nevojshme vërtetimi i ndonjë fakti relevant për shqiptimin e dënimit dhe për këtë arsye ka vazhduar me shqiptimin e dënimit.

Duke vlerësuar në aspektin juridik gjykata gjeti se në veprimet e të akuzuarit ekzistojnë të gjitha tiparet objektive dhe subjektive të veprës penale lëndimi lehtë trupor nga neni 188 par.1 lidhur me nenin 31 të KPRK-së sikurse me datë, vend dhe kohë siç është përshkruar hollësisht në dispozitivat e këtij aktgjykimi.

Me rastin e matjes së llojit dhe lartësisë së dënimit për të akuzuarit, Gjykata vlerësoj rrethanat në kuptim të nenit 73 të KPRK-ës dhe gjeti si rrethanë veçanërisht lehtësuese se të akuzuarit kanë pranuar fajësinë, duke e shprehur pendimin e sinqertë dhe

real për veprën penale të kryer, sjelljen korrekte gjatë tërë procedurës, në rastin konkret nuk gjeti ndonjë rrethanë rënduese, vetë pranimi i fajësisë nga ana e të akuzuarve dhe rrethanat në të cilën ka ndodhur ngjarja, përveç që vlerësoj shkallën e përgjegjësisë penale të akuzuarit si dhe rrezikshmërinë konkrete të veprës penale, Gjykata është bindur se dënimi i shqiptuar ndaj të akuzuarve është në harmoni me peshën e veprës penale, me shkallën e përgjegjësisë penale të akuzuarve dhe me dënimin e shqiptuar me gjobë do të arrihet qëllimi i dënimit siç parashihet në dispozitat e nenit 41 të KPRK-së.

Gjykata konformë nenit 461 parag.1.të KPPK-së të dëmtuarit [REDAKTUAR] nga [REDAKTUAR] rruga "[REDAKTUAR]" dhe [REDAKTUAR] vendi i lindjes në [REDAKTUAR] me vendbanim në [REDAKTUAR]

Vendimi mbi kompensimin e shpenzimeve të procedurës penale dhe paushallit gjyqësor është sjell në bazë të nenit 450 par.2 nënpar.2.6 lidhur me nenin 453 par.1 të KPPK-së dhe nenit 39 parag.1 nën par. 3.1 të Ligjit për Kompensimin e Viktmave të Krimet Nr.05/L-036.


Nga arsyet e sipër cekura është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ

P.nr.2569 /15 me datë 06.03.2018

Zyrtar ligjor,
Blend Rexhepi

Gjyqtari,
Adem Shabani



Këshilla juridike: Kundër këtij aktgjykimi mund të ushtrohet ankesë në afat prej 15 ditëve, pas pranimit të kopjes me shkrim të këtij aktgjykimi, Gjykatës së Apelit në Prishtinë. Ankesa i dorëzohet Gjykatës Themelore në Ferizaj.